

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DELVINA TRADE ENERGY” SH.P.K

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, sot më datë 15.08.2022, Ortaku i Vetëm i shoqërisë:

- **Z. Gëzim Tafhasaj**, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1966, në Kukës, banues në Kukës, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G60508051S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e Ortakut zotërues të 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë;

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“DELVINA TRADE ENERGY” SH.P.K.**, në vijim referuar si **“Shoqëria”**.

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1 *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2 Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3
SELIA

- 3.1 Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.



- 3.2 Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Prodhimin e energjisë elektrike nga djegia e gazit natyror nëpërmjet gjeneratorëve me djegie të brendshme apo turbo gjeneratorëve, me qëllim tregtimin e saj brenda dhe/ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Çdo aktivitet tjetër të dobishëm ose të nevojshëm për arritjen e objektit të saj ose që ka lidhje me të në kuptimin më të gjerë të fjalës.

Për të realizuar objektin e veprimtarisë së saj, shoqëria mund të veprojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të lidhur, instrumental, të dobishëm, të përafërt, elementar, etj në funksion dhe në nevojë të veprimtarisë së saj.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i pashlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë, si më poshtë:
- **Z. Gëzim Tafhasaj**, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1966, në Kukës, banues në Kukës, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G60508051S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 100.000 (njëqind mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë;

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR



2

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, *i ndryshuar*.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1 Emërohet si Administrator i Shoqërisë **Z. Gëzim Tafhasaj**, shtetas shqiptar, lindur më 08.05.1966, në Kukës, banues në Kukës, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: G60508051S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, *i ndryshuar* dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4 Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË “DELVINA TRADE ENERGY” SH.P.K.

Z. GËZIM TAFHASAJ

